

Në muajt e parë të jetës, fëmijët kërcënohen veçanërisht nga rreziku i zhvillimit të formave të rënda të kollës së mirë dhe mbeten të prekshëm derisa të kenë marrë të paktën dy dozat e para të vaksinimit.

Mund të fillosh mbrojtjen e fëmijës tënd edhe përpara se të lindë, duke u vaksinuar kundër kollës së mirë gjatë shtatzënisë.

Nënë, vaksinoju edhe kundër gripit!

Mos harro se në qoftë se je në tremujorin e dytë dhe të tretë të shtatzënisë gjatë periudhës së gripit, është gjithashtu shumë e rëndësishme që të vaksinohesh edhe kundër kësaj sëmundje! Në fakt, tek gratë shtatzëna gripi mund t'i krijojë nënës komplikime serioze (pneumoni dhe vështirësi në frymëmarrje) por gjithashtu mund të jetë edhe shkaku i abortit, lindjes së parakohshme dhe anomalive kongjenitale të fetusit.



Nënë,
mos
rreziko!
Vepro tani
për të mbrojtur
fëmijën tënd nga
kolla e mirë

FOL ME GJINEKOLOGUN TËND DHE VIZITO FAQET E
INTERNETIT:

SALUTE.REGIONE.EMILIA-ROMAGNA.IT
WWW.SAPERIDOC.IT

 Regione Emilia-Romagna



SERVIZIO SANITARIO REGIONALE
EMILIA-ROMAGNA

Sa është e rrezikshme kolla e mirë për fëmijët e vegjël?

Kolla e mirë është një sëmundje shumë serioze, veçanërisht në vitin e parë të jetës. Në fakt, në këtë grupmoshë, sëmundja nuk paraqitet me sulme të kollitjes, por me një krizë të apnesë, në të cilën fëmija ndalon frymëmarrjen.

Mund të shkaktojë gjithashtu pneumoni, insuficiencë të rëndë respiratore, dëme të përhershme të trurit dhe madje edhe vdekje. Pothuajse gjithmonë fëmijët e prekur nga kolla e mirë me moshë nën vitin e parë të jetës duhet të shtrohen në spital.

Në Itali, vdekjet nga kolla e mirë janë të rralla, por vitet e fundit është regjistruar një rritje e rasteve ku sëmundja ka shkakuar disa vdekje.

Si duhet të mbrohemi?

Vaksinimi kundër kollës së mirë është metoda më efikase për të shmangur marrjen e sëmundjes.

Si transmetohet kolla e mirë?

Kolla e mirë është një sëmundje shumë ngjitëse dhe përhapet nga personi në person me teshtitje, kollitje dhe në situatat kur kemi një bashkëndarje të hapësirës së frymëmarrjes, për shembull kur fëmija është i mbështetur në gjoksin e nënës. Të rriturit dhe fëmijët më të mëdhenj me kollë të mirë shpesh shfaqin simptoma jo tipike që mund të ngatërrohen me ftohjet e zakonshme me kollë. Për këtë arsye këshillohet që të kontrollohet gjendja e vaksinimit e personave që do të kujdesen nga afër për fëmijën e tyre.

Pse është e rëndësishme të bëjmë vaksinimin gjatë shtatzënisë?

Vaksina kundër kollës së mirë rekomandohet gjatë tremujorit të tretë të shtatzënisë. Në këtë mënyrë, nëna prodhon antitrupa që kalojnë tek fëmija, përpara lindjes. Këto antitrupa do ta mbrojnë atë në muajt e parë të jetës, derisa të marrë dy dozat e para të vaksinës dhe të fillojë të prodhojë antitrupa të tij.

Si quhet vakcina kundër kollës së mirë?

Vaksina që duhet bërë është ajo kundër difterisë-tetanosit-kollës së mirë [acelulare] (dTpa) e cila ofron mbrojtje kundër të tria këtyre sëmundjeve. Nuk ekziston një vaksinë monovalente vetëm kundër kollës së mirë.

Mund të fillosh mbrojtjen e fëmijës tënd nga kolla e mirë edhe përpara se të lindë, duke u vaksinuar në tremujorin e tretë të shtatzënisë



Çfarë është Cocooning?

Cocooning, ose strategjia e kukules, është një mbrojtje indirekte e fëmijës. Konsiston në sigurimin që të gjithë ata që janë rreth të porsalindurit të jenë të vaksinuar kundër kollës së mirë dhe së fundmi të kenë përsëritur vaksinën kohët e fundit. Cocooning mund të mos jetë e mjaftueshme për të parandaluar infeksionin dhe sëmundjen, por zvogëlon rrezikun.

Në qoftë se e kam bërë këtë vaksinim njëherë, a është e nevojshme që unë ta përsëris atë?

Po, sepse antitruapat e prodhuar si rrjedhim i vaksinimit arrijnë sasinë maksimale pas rreth 2 javësh dhe më pas fillojnë të ulen. Prandaj, vakcina rekomandohet për secilën shtatzëni, në mënyrë që çdo foshnjë të ketë mbrojtjen maksimale të mundshme.


Nëse e kam kaluar kollën e mirë në të kaluarën, a duhet ta bëj gjithsesi vaksinimin?

Po, sepse ndryshe nga sëmundjet e tjera të fëmijërisë, imuniteti i dhënë nga sëmundja nuk është i përhershëm, por zvogëlohet gradualisht me kalimin e kohës.

A është e sigurt vakcina për nënën dhe për fëmijën?

Po. Vaksina kundër kollës së mirë është shumë e sigurt si për nënën ashtu edhe për fëmijën. Efektet anësore më të zakonshme janë të lehta, të tilla si skuqje, ënjtje dhe dhimbje në vendin e injeksionit dhe kalojnë brenda pak ditësh. Vaksina nuk mund të shkaktojë kollën e mirë sepse është një vaksinë acelulare dhe nuk përmban baktere të gjalla. Gjinekologët dhe mamitë e rekomandojnë vaksinimin kundër kollës së mirë gjatë tremujorit të tretë të shtatzënisë.

A është e vërtetë se rastet e kollës së mirë në fëmijët janë duke u shtuar?



Në vitin 2015 në Bologna një fëmijë një muajsh ka vdekur për shkak të kollës së mirë.

